




Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority



Vendimi Nr.75/24
Datë: 26.08.2024

Duke u bazuar në nenin 11, 13, 15, 16, 17, 18, 26, 27 dhe nenin 55 nën paragrafi 1.5, të Ligjit Nr. 08/L-056, Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, Për Procedurën e Parashtrimit të Kërkesave për Lejimin e Përqendrimit dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit dhe Udhëzimit Administrativ Nr.01/2023, Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Përkates, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës, në mbledhjen e datës 26.08.2024, mori këtë:

V E N D I M

I. LEJOHET. Përqendrimi i ndërmarrjeve, lidhur me marrjen e kontrollit të vetëm, mbi Cura Domo Holding GmbH nga Mavie Next GmbH.

II. Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim, obligohet të paguajë taksën administrative prej 1,000.00 €, me shkronja (një mijë euro), dhe Vendimin për Realizimin e Përqendrimit, në përputhje me nenin 55, paragrafi 1.5 të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 24 i Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 6,000.00 € me shkronja (gjashtë mijë Euro).

Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës me datë: 08.07.2024, me Nr. Prot. 434/24-11/H, ka pranuar kërkesën për Njoftim të Përqendrimit lidhur me marrjen e kontrollit të vetëm, mbi Cura Domo Holding GmbH nga Mavie Next GmbH.

Procedurat e ndjekura

1. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë: 24.07.2024;
2. Njoftimi për realizimin e përqendrimit në web faqen e AKRK-së me datë: 24.07.2024;
3. Palët kanë lidhur Marrëveshjen për Blerjen e Aksioneve, të nënshkruar më 10 Qershor 2024.

Baza Ligjore dhe akti i Përqendrimit

Sipas nenit 13, të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimi për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

1. Qarkullimi i kombinuar i palëve në tregun ndërkombëtar e kalon shumën 20,000,000 Euro;
2. Qarkullimi i një pale në Përqendrim e kalon shumën 1,000,000 Euro;

3. Palët kanë lidhur Marrëveshjen për Blerjen e Aksioneve, të nënshkruar më 10 Qershor 2024.

Palët në Përqendrim:

Mavie Next GmbH, me seli në Rothschildplatz 4, 1020 Vjenë, Austri, është kompani e lidhur e UNIQA Group (blerësi). UNIQA Group përfshin grup kompanish të drejtuara nga UNIQA Insurance Group AG, Austri, e cila ofron produkte dhe shërbime sigurimesh kryesisht në Austri, Evropë Qendrore dhe Lindore. Uniqa Group është e pranishme në Kosovë, përmes dy filialeve, SIGAL LIFE UNIQA Group AUSTRIA sh.a. dhe SIGAL UNIQA Group AUSTRIA sh.a. Cura Domo është biznes familjar nga Austria, i madhësisë së mesme. Kjo kompani ofron shërbime në fushën e kujdesit 24 orë, në qendra të kujdesit (jetesë e asistuar) dhe menaxhime të objekteve. Targeti nuk ka kompani të lidhura në Kosovë dhe as nuk ka gjeneruar qarkullim në Kosovë.

Cura Domo Holding GmbH, me seli në Muhlgasse 13, 2320 Schwechat Austri, është biznes familjar nga Austria, i madhësisë së mesme (targeti). Kjo kompani ofron shërbime në fushën e kujdesit 24 orë, në qendra të kujdesit (jetesë e asistuar) dhe menaxhime të objekteve. Targeti nuk ka kompani të lidhura në Kosovë dhe as nuk ka gjeneruar qarkullim në Kosovë

Tregu i produktit, përfshinë shërbimet e shtëpisë së kujdesit, kujdes shtëpiak dhe menaxhime të objekteve.

Tregu gjeografik, Tregu përkatës gjeografik, bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr.01/2023, tregu gjeografik do të jetë tregu që përfshinë zonën në të cilën ndërmarrjet përkatëse përfshihen në furnizimin dhe kërkesën e mallrave ose shërbimeve, në të cilën kushtet e konkurrencës janë homogjene dhe mund të dallohen nga kushtet në zonat fqinjë. Në këtë rast, tregu gjeografik mund të lihet i hapur.

Analiza e konkurrencës

Transaksioni i propozuar nuk paraqet ndonjë shqetësim për konkurrencën në tregun përkatës, pasi palët nuk kanë synim të operojnë në Kosovë, ato operojnë në Republikën e Austrisë. Transaksioni nuk rezulton në mbivendosje horizontale apo marrëdhënie vertikale ndërmjet aktiviteteve të palëve, duke eliminuar kështu çdo shqetësim të mundshëm për konkurrencën. Për këtë arsye, çështja e përcaktimit të saktë të tregut gjeografik, mund të mbetet e hapur.

Efektet e konkurrencës në tregun përkatës nga transaksioni i realizuar

Transaksioni kryesisht do të zhvillohet në tregun e Republikës Austriake. Kërkesa për njoftim të përqendrimit është bërë, për arsye se Mavie Next është kompani e lidhur e Uniqa Group e cila është aktiv në Kosovë përmes dy filialeve, SIGAL LIFE UNIQA Group AUSTRIA sh.a. dhe SIGAL UNIQA Group AUSTRIA sh.a. Sipas vlerësimit të përqendrimit, nga ky transaksion nuk do të ketë efekte negative për konkurrencën, e rrjedhimisht për konsumatorët në Republikën e Kosovës, për arsye se Mavie Next dhe Cura Domo nuk janë fare prezentë në Kosovë. Nga të dhënat e ofruara konsiderojmë se implementimi i transaksionit nuk do të ketë efekt negativ në tregun kosovar, e rrjedhimisht nuk ka mundësi të kufizimit ose shtrembërimit të konkurrencës në tregun përkatës. Divizioni i Përqendrimeve ka vlerësuar se ky transaksion, nuk do të paraqesë

efekte negative në konkurrencë, për arsye se ky transaksion/blerja nuk do të ndikojë në forcimin e pozitës dominuese të ndërmarrjes blerëse tek operatorët ekonomik apo konsumatorët, përkatësisht objekti i kontratës nuk korrespondon, me tregun përkatës të Republikës së Kosovës.

Shënim:


Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti-konkurrese, do të jetë nën monitorimin e Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës.

Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij, Vendimi.


Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

**AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI**

Neime Binaku-Isufi
Kryetare



Kaltrina Sela
Nënkryetare



Nafije Osdautaj
Anëtare



Florent Mehmeti
Anëtar

Salihe Gashi-Loku
Anëtare



III. Me këtë Vendim, të njoftohen:

- Palët
- Arkiva